



BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4213/prot.
/1

Ballsh, më 23.10.2025

PROCESVERBAL
(I zbardhur nga origjinali)

Për:

Dëgjesën publike me banorët e Njesisë Administrative Fratar.

Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi	Struktura
Fratar	23.10.2025	11:00	Pranë market 'Hasanj'	Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale

Pjesëmarrja	
Nga Bashkia Mallakastër	
Znj. Armela Malaj	Zv/kryetare
Z. Aleksandër Rama	Drej. Drejtoria Ekonomike dhe Ç. Sociale
Z. Agetin Merkaj	Përgj. i Tatim Taksave
Znj. Rovenë Osmënaj	Koordinator për konsultimin dhe njoftimin e publikut
Nga Këshilli Bashkiak	
Z. Nexhmi Sulaj	Kryetar këshilli
Znj. Zinaida Ahmetaj	Sekretar i këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : ishte 26, 18 burra dhe 8 gra.

e market "Hasanaj", Damës, për :Hartim 1: Paketa Fiskale 2026, Projekt Buxheti i vitit 2026, Projekt Buxheti Afatmesëm 2026-2028.

Nr	Emër	Mbiemër	Firmë	Nr.telefoni
1	Xhoana	Serjona		
2	Ajekolite	kopllona		
3	Sey	Serjona		
4	Beone	Hasona		
5	Ableet	Matez		
6	Sokot	Terote		
7	Pellumbi	kopllona		
8	Dimo	Hyseme		
9	Enteta	Muçaj		
10	Bermetta	Likaj		
11	Holine	Glauaj		
12	Merushë	Heminaj		
13	Arma	Murataj		
14	Artoso	Dotte		
15	Arlova	Kopllona		
16	Agoliam	Dervishaj		
17	duan	Sulaj		
18	FATZON	KHAFER		
19	Moutiam	Hulcaj		
20	Moruce	Hulcaj		
21	Xhevrit	Zemjeli		
22	Ermeta I	Sulaj		
23	Arçli	Selo		
24	Agulm	Hasan		
25	Hasan	Hemaj		
26	Levan	Sulaj		
27				

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: Hartimi Paketës Fiskale 2026, Buxheti Vjetor 2026 dhe P.B.A-në 2026-2028.

Dëgjuesën e hapi Kryetari i Këshillit Z. Nexhmi Sulaj duke vën në dijeni qytetarët me temën e dëgjuesës dhe duke falenderuar ata që marrin pjesë në këtë dëgjësë.

E merr fjalën Zv/Kryetari Bashkisë Znj. Armela Malaj, burimet e të ardhurave të bashkisë janë:

- Nga taksat dhe tarifatat vendore
- Grantet e projekteve
- Të ardhurat nga qeveria në formë grantesh, të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara sektoriale..

Duam të bëjmë një ndërgjegjësim të banorët e Mallakastrës për pagesat e takasave dhe tarigave në kohën e duhur, duke rritur kështu pritshmërinë e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.

Për sa i përket shpenzimeve që bën bashkia janë për:

- Shërbimet publike
- Arsimin dhe kulturën
- Shëndëtesinë dhe mbrojtjen sociale
- Infrastrukturë në kopshte, çerdhe, shkolla etj.

Për vitin 2026 i është dhënë prioritet projekteve me bashkëfinancim, si

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonat rurale
- Rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve
- Sistemin e kanalizimit të ujrave, të bardha dhe të zeza
- Aktivitetet kulturore
- Mbështetje për bujqësinë
- Mbështetje e bizneseve të vogla, nxitja e agroturizmeve.

Nuk kemi ndryshim në tarifatat vendore, përveç shtimit të tarifimit për shërbimin e pastrimit gjelbërimit, në zonat ku do të shtrihet ku shërbim.

Z. Aleksandër Rama: shtimi i taksës së pastrimit do bëhet pasi të indetifikohen familjet ku do bëhet ky pastrim, pastaj do fillojë faturimi, për këtë arsye kemi parashikuar dhe shtimin e mjeteve të pastrimit. Momentalisht janë duke përfunduar dy projekte, rikonstruksioni i rrugëve në Njësinë Administrative Qendër dhe Njësinë Administrative Kutë. Prioritet i bashkisë është lidhja e rrugëve nacionale me ato rurale. Aktualisht shkolla 'Gjok Doçi' Fratar, është drejt përfundimit dhe pritet fillimi i rikonstruksionit të shkollës 'Ismail Klosi' në Ballsh. Rikonstruksioni i rrugëve : Kremëtar dhe Gadurovë janë në fazë prokurimi dhe vitin tjetër fillon zbatimi në terren.

Investimet të tjera të parashikuara:

- Investime për ujësjellëskanalizime, kanalizimin e ujrave dhe sistemin e rrugëve të tokave bujqësore dhe sistemin e vaditjes dhe kullimit
- Mjedis; mbjellje të sipërfaqeve të zhveshura, ripyllëzim, ndalimin e prerjeve të paligjshme, etj.

- Përmirësim në shërbimin zjarrëfikës, shtim të strukturave përkatëse
- Për bujqësinë, pika grumbullimi sa më të afërta, mundësi fermerëve për promovimin e produkteve, bashkëpunim me bizneset për produktet blektorale dhe bujqësore

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z.Pëllumb Dajlanaj (kryetari i fshatit Ninësh) – paraqet problematikat e zonës së Ninshit.

1. Kërkesë për rrugën e fshatit ku lidhemi me Levanin e Tepelenës, me qënë se ka filluar të ketë lëvizje të turizmit
2. Kemi tri lagje me rrugë të shkurtra, që janë në gjendje të mjerueshme; Kllezëm, Demaj, Merdhaj.
3. Godina e ish-kinemasë, është amortizuar, duhen marr masa për katin e dytë të kësaj godine.
4. Rruga e lagjes Mahmutaj, është mbyllur, dikush ka hapur një kanal, dikush ka bër mur, etj.
5. Lagjia Ramaj në verë ngelet pa ujë.

Znj. Armela Malaj: Rrugët e lagjeve nuk janë të përfshira në këtë program, do të shikojmë mundësi të bëjmë diçka me mjetet e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike. Kurse rrugët nëpër pronat e arave që mund të jenë asset i bashkisë, nuk i tjetërsojmë dot dhe as ndërhyjmë, vetëm nëse bëhet me mirëmbajtje.

Z. Isuf Serjanaj (kryetari i fshatit Çerril) -. paraqet problematikat e zonës.

Në punimet që bëri bashkia për shtrimin me çakull të rrugës Selitë-Çerril, as kanale dhe as tubacione nuk janë vendosur në anë të rrugës, me shiun që ie do lahet rruga përnjëherë e do bëhet kanal kanal.

Në projekt buxhetin që prezantuat nuk ishte përfshirë asnjë zë për Selitën dhe Gjerbsin, na keni lënë pas dore, s'është investuar as për rrugë e as për ujë.

Znj. Armela Malaj – Unë përmenda investimet madhore të cilat do të realizohen me bashkëfinancim me Fondish Shqiptar të Zhvillimit. Në Bardhaj u bë rruga dhe pjesa tjetër nga Selita në Çerril dhe kanalizimet dhe tubacionet do të realizohen në një fazë të dytë.

Z. Klodian Nuka – Çfarë është bër për fshatin Bejar në këto vite?

Znj. Armela Malaj: - Si fillim duhet t'a kishe folur me administratorin e Njesisë Administrative, që çfarë të mungon ty në fshatin tënd.

Pyetja e radhës vjen nga doktorri i qëndrës shëndetësore Fratar **Z. Hamzo Hasanaj:**- Pse nuk ka një investim për kënde sportive dhe parqe për zonën e Fratarit?

Z. Klodian Nuka – Rruga na mungon.

Znj. Armela Malaj: - Do t'a shënojmë si problematikë.

Z. Klodian Nuka: - Çfarë keni bër për kontrollimin e fabrikave të vajit, dhe lëngjyrave që ata derdhin?

Znj. Armela Malaj: - Nga bashkia janë ngritur grupe pune, kanë bër verifikime dhe janë përcjell dhe në Fier pranë inspektoriatit.

Z. Avdi Salaj (kryetari i fshatit Drizar) – Çfarë është bër në lidhje me problematikën që shkaktoi rikonstruksioni i rrugës së Drizarit te varrezat. Azhornimi akoma s'ka mbaruar na thanë që do kryej Brenda 45 ditësh.

Znj. Armela Malaj: - Azhornimi po realizohet sipas zonave.

Z. Gramos Hodaj,banor i fshatit Drizar: - Kërkojmë investim për rrugën sepse po bëhet e pakalueshme, kemi kemi pleq, kemi fëmijë.

Z. Bedri Hasanaj, banor i Selitës,- Kërkojmë të ket një infermier në fshat, kemi problem shëndetësore e s'kemi ku masim tensionin.

Znj. Armeal Malaj: - Po keni qendrësn shëndetësore në Kapaj, nuk ka infermier atje?

Mbyll dëgjesën publike kryetari i Këshillit Bashkiak të Mallakastrës Z. Nexhmi Sulaj, duke falënderuar pjesëmarrësit në këtë dëgjesë dhe siguruar se të gjithat kritikrat që u shprehën do të shqyrtohen nga bashki dhe këshilli.

Faleminderit!

MBAJTËS PROCESVERBALI

Koordinator për konsultimin dhe
njoftimin e publikut
Rovena Osmënaj



Sekretar Këshillit

Zinaida Ahmetaj

